

Dr. Matilda Likaj Shaqiri*

Ndikimi i medias lokale në perceptimin e shoqërisë shqiptare për refugjatët dhe krizën

Abstrakt

Në dy vitet e fundit, rrymat emigratore refugjate dhe kriza e vendeve pritëse evropiane është një temë e nxehtë sa politike aq dhe mediatike. Normalisht, media duhet të jetë transparente në paraqitjen e lajmeve rreth politikbërjes, kushteve të pranimit dhe problematikave që ky fenomen sjell. Për shkaqe të ndryshme të cilat mund të jenë shumë të diskutueshëm, aktualisht mediat evropiane paraqesin lajme tepër telegrafike statistikore ose stereotipa të problematikave që refugjatë mund të formojnë. Mediat lokale shqiptare (të cilat marrin si shembull mediat evropiane), i paraqesin lajmet në të njëjtën mënyrë si ato evropiane. Këto lajme influencojnë mendimin e publikut, për të qëndruar indiferent ndaj fenomenit të refugjatëve prej vendeve të lindjes së mesme.

Në këtë studim analizohet shkurtimisht trajtimi i fenomenit të refugjatëve prej lindjes së mesme dhe kriza e emërtuar prej vendeve evropiane, në mediat lokale dhe ndikimi i tyre në shoqërinë shqiptare. Në vijim të studimit gjenden diskutime rreth përcaktimit të termit emigrant dhe refugjatë, si dhe analizimi i rolit të medias në prezantimin e këtij fenomeni në ditët e sotme.

Fjalët kyçe: media lokale, refugjatët, emigrantët, kriza, lindja e mesme

*Departamenti i Shkencave të Edukimit, Kolegji Universitar Bedër.
Email: matildalikaj@gmail.com

Hyrje

Pas luftës së dytë botërore, si shkak i Pranverës Arabe në lindjen e mesme dhe Afrikë, bota përballet me rrymën më të madhe të refugjatëve. Sidomos me luftën e brendshme në Siri, rrymat emigrante refugjate si fillim u drejtuan në vendet si Jordania, Libania dhe Turqia. Në këtë periudhë kohe, media perëndimore (sidomos ajo evropiane) u ka përkushtuar shumë pak vend lajmeve të lidhura me këtë fenomen. Që prej vitit 2015, rryma refugjate siriane u drejtua në vendet evropiane, sidomos Gjermania, Franca, Suedia etj. Përballja e vendeve evropiane me rrymën e refugjatëve sirian, vuri në lëvizje të gjithë mekanizmat politike dhe institucionale për ta përfshirë këtë fenomen si një ndër problematikat aktuale më të diskutueshme. Media, që shpesh herë përcaktohet si *'watching dog'*, e përqëndroi fokusin në trajtimin e këtij fenomeni si lajm (vizivë dhe i shkruar). Pra, shfaqja e fenomenit të emigrimit (në këtë rast refugjatët sirian) u trajtua për herë të parë në mediat evropiane dhe mediat e tjera ndërkombëtare, pas paraqitjes si problematikë prej qeverive evropiane, sidomos asaj Gjermane. Sot rrymat emigratore refugjate siriane dhe të vendeve të tjera të vendeve të lindjes së mesme, përcaktohen si më të mëdha në historinë e njerëzimit dhe si një krizë për përballimin e tyre.

Analizimi i fenomenit të refugjatëve sirian në këtë artikull do të realizohet nëpërmjet qasjes deskriptive se si lajmet lokale ndikojnë në ndryshimin e perceptimeve të shoqërisë shqiptare. Për realizimin e artikullit u pa i domosdoshëm diskutimi i termave emigrim, kizë, refugjatë sirian dhe analizimit të mediave evropiane dhe ato lokale shqiptare.

1-Emigrimi, refugjatët dhe kriza sot

Që prej fillimeve të njerëzimit, migrimet (të brendshme dhe të jashtme) janë konsideruar si fenomene që karakterizojnë grupe të ndryshme sociale në të gjitha shoqëritë botërore.

Emigrimi është një fenomen shumëdimensional, i cili nëpërmjet faktorëve nxitës dhe shtytës ndikon në dinamikën e popullsisë, zhvillimin rajonal, ekonomik, social dhe politik. Ky fenomen përfshin

aspektin e zhvillimit ekonomik dhe ndryshimeve sociale në nivel lokal dhe në atë global¹. Lëvizja e individëve nga një vend në tjetrin vazhdon të jetë një ndikues i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, ndryshimet sociale, ndryshimet kulturore dhe organizimin politik të vendit të origjinës por edhe atij pritës.

Shumëllojshmëria e vet fenomenit, ka ndikuar në studime dhe analiza akademike të disiplinave të ndryshme. „Durkheim mendon se fenomenet shoqërore formohen kur individët ndërveprues bëjnë realitet një veprim të përbashkët social². Pikërisht, ndërveprimet janë elementët që formojnë shumëllojshmërinë e këtij fenomeni. Shpjegimi i termit të emigrimit ka disa variante të ndryshme, të cilat shpesh herë kanë ngjallur diskutime të shumta. Disa prej tyre janë —migrimi është lëvizja e individëve nga një zonë gjeografike drejt një tjetre, si shkak i ndryshimeve demografike, sociale, politike, kulturore etj”³ apo —migrimi është një fenomen universal që disa prej studiuesve social e spekulojnë dhe interpretojnë sikur të ishte instiktive në natyrën e njeriut që emigron”⁴. Sipas Kizilcelik dhe Erjem, fenomeni i emigrimit përcaktohet si largimi i individëve nga një vend në një tjetër për arsye ekonomike, sociale, kulturore etj. Ndër arsyet kryesore të tij mund të radhiten faktorët social, ekonomik, politik dhe arsimor etj.⁵ Unal dhe Demir, duke u referuar në studimet emigratore të Fitcher’it, e përcaktojnë fenomenin e emigrimit si shkak të ‘lëvizjeve sociale’, që zhvillohen prej ‘lëvizjeve fizike dhe sociale të individëve’⁶. Kështu që, emigrimi paraqitet si një proces që përfshinë disa fenomene të ndikuara prej demografisë, ekonomisë,

¹ Athenosy, *Migration in Europe: The CEB’s Experience*, 17.

² Coser & Ridener, *Teoritë Sociologjike: Nga fillimet deri në ditët tona*, 84.

³ Athenosy, *Migration in Europe: The CEB’s Experience*, 12.

⁴ Scott, *World Migration in Modern Times*, 15.

⁵ Kizilcelik & Erjem, *Açıklamalı Sosyoloji Terimler Sözlüğü*, 20.

⁶ Unal & Demir, *Göç, Kimlik ve Aidiyet Bağlamında Türkiye’de Balkan Göçmenleri*, 6.

socio-politikës së shoqërisë si dhe lëvizjes nga një vend në tjetrin për një periudhë të caktuar kohe ose për gjithmonë⁷.

Në ditët e sotme, në rendin botëror, pabarazia e të ardhurave financiare mes vendeve të zhvilluara, vendeve në zhvillim dhe atyre të pazhvilluara, drejton individët dhe grupe të shtresave sociale të ndryshme, në kërkim të mundësive të reja, për tu larguar prej vendit të tyre drejt vendeve të tjera. Zakonisht, individët largohen për një jetë më të mirë. Emigrimi i aktorit social është lëvizja e tij nga një vend në një tjetër, duke pasur qëllim të vazhdojë jetën me qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm në vendin pritës. Si në shkencat sociale dhe në jetën e përditshme, kjo lëvizje njihet si emigrim ose fenomen emigrator. Sipas përkufizimit të përdorur gjerësisht në shkencat sociale, emigrantët janë persona që jetojnë jashtë vendit ose shtetit të tyre të lindjes për një kohë të gjatë dhe qëndrojnë aty për arsye të ndryshme (ekonomike, politike, sociale, kulturore etj).

Fenomeni i emigrimit është karakterizuar si një ndër fenomenet më të vjetra sociale (që prej fillimit të njerëzimit) të grupeve dhe të shoqërive të ndryshme në botë. Gjatë historisë së njerëzimit, për mijëra vjet individët kanë lëvizur (migruar) në kërkim të ushqimit, mbijetesës, për të kolonizuar ose pushtuar, për të shpëtuar prej kolonizimeve ose pushtimeve, për t'u larguar prej luftës ose autoriteteve të politikës, për të kërkuar mundësi të reja dhe të dobishme për jetesën e tyre etj. Kjo lëvizje mund të jetë për një afat të shkurtër apo të gjatë, për arsye ekonomike, politike, kulturore apo edhe sociale. Lëvizja mund të jetë e rregullt/ ligjore ose parregullt/e paligjshme⁸. Emigrimi i individëve paraqitet në forma të detyruara (jo vullnetare) ose të dëshiruara (vullnetare). Megjithatë, largimi i individëve nga një vend në tjetrin, mund të ketë arsye të ndryshme dhe tepër të ndërlikuara. Sipas studimit "Njohuri të përgjithshme rreth fenomenit emigrator" nuk është e vështirë të identifikosh përsë

⁷Çakır, *Türkiyede Göç, Kentleşme/Gecekondu Sorunu ve Üretilen Politikalar*, 212.

⁸Lucas, *International Migration and Economic Development: Lessons from Low-Income Countries*, 71.

largohen individët. Veçanërisht nga zonat e varfra në ato të pasura, largimi bëhet për kushte më të mira për veten dhe familjen⁹.

Sipas statistikave, deri në vitin 2005 në mbarë botën paraqitetin rreth 200 milion emigrantë. Në këtë numër përfshiheshin edhe 9 milion refugjatë. Kjo shifër është afërsisht ekuivalente me shtetin e pestë me popullsi më të madhe në botë, Brazilin. Duke u referuar te kjo statistikë një në çdo 35 individë në botë është emigrantë¹⁰. Numri i madh i emigrantëve në botë, ndikon te përcaktimi i termave të fenomenit të emigrimit. Gjatë analizës së termit të emigrimit vihet re një diversitet përkufizimesh, ndonjëherë edhe paqartësi në përcaktimin e këtij termi. Për këtë arsye është e rëndësishme të realizohet përkufizimi i termit migrim (emigrim dhe imigrim), termit emigrant, imigrantë dhe llojeve të emigrantëve. Migrant, është një person, i cili në mënyrë vullnetare dhe për arsye të ndryshme personale, lëviz nga vendi i tij i origjinës, në një destinacion të posaçëm, i detyruar ose jo. Këtu përfshihen personat që lëvizin në mënyrë rregullt ose të parregullt. Kjo nënkupton se jo të gjithë prej këtyre individëve kanë dokumentacionet e nevojshme si vizë, leje qëndrimi apo leje pune, përfshihen në këtë përkufizim. Ndërsa azil kërkues, janë individë, të cilët kërkojnë të pranohen në një vend tjetër si refugjatë dhe gjenden në pritje të vendimit mbi aplikimin e tyre për statusin e refugjatit, sipas instrumenteve përkatëse të ligjit ndërkombëtar¹¹. Azil kërkues përcaktohet individi, i cili kalon kufijtë ndërkombëtar për shkak të luftës, fatkeqësive, frikës nga persekutimi etj në vendin e tij të origjinës. Individi emërtohet si azil kërkues për sa kohë që nuk ka marrë ende përgjigje, apo vendim mbi kërkesën e tij. Derisa kërkesa të trajtohet, azil kërkuesi ka të drejtë të mos kthehet në vendin e origjinës. Azil kërkuesit e vendeve të lindjes së mesme, nuk kanë ndërmarrë një emigrim individual. Ata janë pjesë e rrymës emigratore refugjate drejt vendeve të ndryshme të Evropës. Destinacioni i tyre pavarësisht se janë vendet evropiane, harta e

⁹Ikononi, *E drejta Migratore*, 11.

¹⁰Koser, *International migration: A very Short Introduction*, 4.

¹¹Pozdorovkin, *Handbook on Migration Terminology*, 13.

udhëtimit të tyre është e formuar sipas rrugës detare nëpërmjet deteve Egje, Mesdhetar, Jon, Adriatik dhe tokësore nëpërmjet Turqisë¹². Kjo rrymë emigratore refugjate paraqet krizë jo vetëm të vendit dërgues (originës), për refugjatët dhe vështirësitë që ata përballen gjatë udhëtimit të tyre deri në mbërritjen në destinacion, për vendet pritëse, dhe politikat emigratore refugjate të të gjitha vendeve.

Situata dhe gjendjet aktuale të këtyre refugjatëve por edhe krizës që është formuar pasqyrohet në media. Informacionet e shumta që qarkullojnë nëpërmjet mediave të ndryshme lokale në Shqipëri, nuk janë veçse pasqyrime të statistikave (që shpeshherë nuk janë të sakta, kur i krahason me ato të mediave ndërkombëtare) dhe nuk përbëjnë një lajm informues për publikun. Në vazhdimësinë e këtij studimi, do të analizohet shkurtimisht pasqyrimi i prezantimit të fenomenit të krizës të emigrantëve refugjatë në vendet evropiane.

2-Roli i medias në prezantimin e fenomenit të emigrimit:

Shembulli i medias shqiptare

Pranvera Arabe, përveç Tunis është shfaqur në të shumë prej vendet e lindjes së mesme si Libia, Jemeni, Siria etj. Përmendim këto vende sepse ato janë vendet kryesore ku zhvillohen luftrat civile më të mëdha në këtë rajon. Luftërat civile kanë qenë faktori kryesor shtytës i individëve për të emigruar nëpërmjet rrymave refugjate në kërkim të azilit në vende të ndryshme. Këto luftra kanë ndikuar në formimin e emigrimit të detyrueshme të individëve. Emigrimi i detyruar është lëvizje me natyrë jovullnetare ose e dëshirueshme e një personi për arsye konflikti, dhune ose dhunimi i të drejtave individuale, katastrofe natyrore apo ngjarje tjetër e natyrës së tillë. Ky term përdoret edhe për lëvizjet e refugjatëve apo shkëmbimet e detyruara të popullsisë midis shteteve. Termi 'emigrim i detyruar' përdoret për të përshkruar një lëvizje migratore në të cilën ekzistojnë elementet e forcës dhe detyrimit, duke përfshirë edhe kërcënime për jetën. Emigrimi i detyruar mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme, siç janë ato

¹²*The long walk to: On the road with migrants feeling violence from the Middle East towards the hope of a new life in the West*, 12.

natyrore ose njerëzore (p.sh. lëvizjet e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, individë që zhvendosen për shkak të fatkeqësive natyrore apo mjedisore, shkaqe të dëmtimeve kimike si shpërthimet bërthamore, zi buke, projekte zhvillimi etj.¹³ Sipas Mason rrymat e emigrimit të detyruar ndodhin si rezultat i një sërë faktorësh të rastësishëm apo të planifikuar, ku disa prej tyre janë persekutimi, katastrofat natyrore dhe industriale, zhvillimi i projekteve, degradimi mjedisor, luftërat dhe konfliktet, diskriminimet etnike etj. Një numër i madh paradigماش janë përdorur si rezultati i faktorëve të shumtë dhe kanë ndikuar në formimin e proces të emigrimi¹⁴. Emigrimi i detyruar padyshim ka shkaqe të shumë, si për vendet pritëse edhe për ato të origjinës. Shpeshherë shkaqet kryesore lidhen me konfliktet fetare, racore ose etnike të vendit të origjinës. Këto shkaqe kanë qenë burimi i luftërave, të cilët kanë nxitur dhe detyruar lëvizjet emigratore. Si shkaqe të tjera që nxisin këtë fenomen mund të përmenden tensionet sociale, zakonisht të shoqëruar nga kriza politike, me grupet opozitare në rritje në shenjë proteste kundër regjimit në pushtet, i cili shpesh është autoritar e i dhunshëm. Represioni i këtyre grupeve nga drejtuesit e vendit të tyre, shpeshherë ka qenë një nga shkaqet kryesore të "emigrimit të detyruar".

Sipas statistikave, numri i refugjatëve sirian ka arritur deri në njëmbëdhjetë milion¹⁵. Megjithatë, këto statistika janë shumë të diskutueshme për shkak të statusit ilegal që refugjatët mund të kenë në vendet pritëse. Rrymat e para emigratore refugjate siriane janë pritur prej vendeve si Turqi, Jordani dhe Libi. Rrymat e tjera kanë pasur si destinacion vendet Evropiane si Gjermania, Franca, vendet nordike etj. Për shkak të destabilizimit dhe paqëndrueshmërisë politike dhe ekonomike, të shkaktuara prej revolucioneve arabe, kësaj

¹³Pozdorovkin, *Handbook on Migration Terminology*, 10.

¹⁴Mason, *Forced Migration Studies: Surveyin the Reference Landscape*, 247.

¹⁵Bayrakli & Keskin, *Turkiye, Multeci ve AB Ucgeninde Multeci Krizi*, 8.

rryme i bashkohen edhe refugjatë prej Irakut, Afganistanit dhe Eritresë.

Nga njëra anë, Lindja e mesme përballet me vazhdimësinë e luftërave civile ndër vite, ndërsa në anën tjetër bota përballet për herë të parë me një krizë kaq të madhe refugjatësh. Shkaku kryesor shtytës i largimit prej vendeve të këtyre individëve është për sigurinë e jetës së tyre dhe të familjarëve. Për të arritur në destinacionin e planifikuar para largimit nga vendi i origjinës, refugjatët sirianë janë të detyruar të zgjedhin rrugët e paligjshme nëpërmjet kalimit në detin Mesdhetar dhe Egje. Deri në nëntor të 2015, në Evropë kanë hyrë në mënyrë ilegale nëpërmjet rrugës së detit 868,282 refugjatë¹⁶. Ndërsa sipas të dhënave të EUROSTAT, në dhjetë muajt e parë të 2015 kanë kërkuar azil 1,061,060¹⁷. Ky është një numër mjaft i konsiderueshëm për tu trajtuar si një fenomen për vendet pritëse dhe ato të origjinës.

Në media ndërkombëtare zënë vend lajme të cilat janë tepër telegrafike rreth refugjatëve. Si individë e kemi në natyrë që të mos e vëzhgojmë të plotë 'pikturën' e një situatë, por të fokusohemi vetëm te njëri prej fragmenteve të kësaj pikturë. Kjo ndodh edhe me median evropiane, e cila paraqet lajme të përcipta rreth fenomenit të krizës së refugjatëve. Deri tani, vetëm media amerikane e trajtojnë krizën e refugjatëve prej vendeve të lindjes së mesme si një fenomen me dimensione të ndryshme, por mbi të gjitha që duhet mbështetur. Megjithatë në trajtimin e këtij fenomeni nuk qëndron jashtë kritikave për politikën e gabuar të Evropës (kritika të cilat vijnë prej politikës së jashtme të bashkimit evropian me atë të SH.B.A-së). Kështu që, nisur prej lajmeve, mund të thuhet se media e trajton fenomenin e rrymave emigratore refugjate të lindjes së mesme si 'kërcenim' për ruajtjen e stabilizimit, solidaritetit e kohezionit social të shoqërive perëndimore. Ngjarjet të formuara prej sjelljeve të një refugjati ose një grupi të vogël refugjatësh, përdoren si paraqitje të etiketimit të gjithë refugjatët. Shumë artikuj gazetash ose lajme vizive, paraqesin

¹⁶Mediterranean update, Missing emigrants projects, 2.

¹⁷Bayrakli & Keskin, *Turkiye, Multeci ve AB Uçgeninde Multeci Krizi*,9.

segmente të stereotipave negative të refugjatëve, të cilat e kanë të lehtë arritjen të audience për të formuar sjellje raciste dhe diskriminuese ndaj refugjatëve. Sipas Iyengar, studimet eksperimentale tregojnë se media e kornizon mendimin e audiencës¹⁸. Pikërisht, kjo ka ndodhur me median evropiane dhe atë shqiptare. Paraqitja e lajmeve të krizës refugjate në mënyrë telegrafike dhe statistikore, ka larguar kujtesën kolektive prej eksodit dhe rrymave emigratore shqiptare, tragjeditë e eksodit detar dhe atë të Otranotos. Media lokale shqiptare e paraqet këtë fenomen sikur mos të kishte aspak lidhje me historinë shumë të afërt të shoqërisë sonë.

Foto 1: Refugjatët sirian drejt Europës- deti mesdhe, 2015¹⁹



**Foto 2: Refugjatët shqiptar drejt Europës- deti Adriatik
1992²⁰**

¹⁸ Shanto, *Is Anyone Responsible? How Television Frames Political Issues*, 52.

¹⁹ Drowning Sirian Refugee, accessed on january, 2017

²⁰ Albanian exodus, accessed on january, 2017.



Konkluzion

Sipas Giddens, media ndikon në formimin e perceptimeve, mendimeve, sjelljeve dhe në riorganizimin e mentalitetit të një shoqërie²¹. Mediat ndërkombëtare, sidomos ato evropiane, bazuar në politikat e emigrimit dhe prej dyndjeve të rrymave të ndryshme refugjate e kanë bërë formë të detyrueshme paraqitjen e lajmeve telegrafike ose të stereotipeve negative. Këto media, kanë si tendencë paraqitjen e këtij fenomeni si një kërcënim për shoqëritë evropiane.

Ndërsa media shqiptare, i paraqesin lajmet sipas modelit të përshtatjes me mediat evropiane. Fenomeni i rrymave emigratore refugjate, pavarësisht se është tepër i njohur në historinë e afërt shqiptare, lajmet rreth fenomenit të rrymës siriane ose të refugjatëve të tjerë prej lindjes së mesme ose Eutopisë paraqiten si h umë të largëta dhe indiferente. Në këtë rast media, jo vetëm që ndikon negativisht për sensibilizim të këtij fenomeni, por ndikon lehtësisht në formimin e ‘harresës kolektive’ të fenomeneve të njëjta që shoqëria jonë është përballur para disa vitesh. Ashtu siç Baudrillard e përcakton median si një ndikues simulark, e njëjta situatë vërehet në shoqërinë tonë. Pra, një vizion që përcaktohet prej medias dhe që shoqëria e pranon ashtu siç i jepet.

²¹ Giddens, Sociology, 351.

Bibliografia:

- Ünal, Serdar & Demir, Gülşen. *Göç, Kimlik ve Aidiyet Bağlamında Türkiye 'de Balkan Göçmenleri*, 6 Ulusal Sosyoloji Kongresi. Toplumsal Donusmeler ve sosyolojik Yaklaşımlar. Aydın: Adnan Menderes Üniversitesi Basın Evi. 2009
- Koser, Khalid. *International migration: A very Short Introduction*. New York: Oxford University Press. 2007
- Athenosy, Lucia. *Migration in Europe: The CEB's Experience*. Council of Europe Development Bank Press. 2008
- Coser, Lewis & Ridener, Larry. *Teoritë Sociologjike: Nga fillimet deri në ditët tona*, Përkthyesi: I. Angoni; Tirana: Plejad 2005:
- Scott, Franklin D. *World Migration in Modern Times*.; USA: Prentice-Hall Press 1986
- Kizilcelik, Sezgin & Erjem, Yasar. *Açıklamalı Sosyoloji Terimler Sözlüğü*. Konya: Emre Yayıncılık. 2000
- Çakır, Sabri. *Türkiyede Göç, Kentleşme/Gecekondu Sorunu ve Üretilen Politikalar*. SDÜ Fen Edebiyat Fakültes. Sosyal Bilimler Dergisi. Sayı: 23 (2011). 209-222
- Lucas, Robert. *International Migration and Economic Development: Lessons from Low-Income Countries*. USA: Edward Elgar Publishing. 2005
- İkonomi, Luljeta. *E drejta Migratore*. Tiranë: IOM Press: 2009
- Pozdorovkin, Olga. *Handbook on Migration Terminology (Russian-English)*. Russia: IOM Publications. 2011
- Mason, Elisa. *Forced Migration Studies: Surveyin the Reference Landscape*. Vol.50 (2000). 241-251
- Giddens, Anthony. *Sociology*. 5th Edition. U.K: Polity Press. 2006
- The long walk to: On the road with migrants feeling violence from the Middle East towards the hope of a new life in the West*. Magazine. September 18, 2015. 10-15
- Bayrakli, Enes & Keskin, Kazim. *Türkiye, Mülteci ve AB Uçgeninde Mülteci Krizi*. SETA. Sayı 143 (2015)
- Mediterranean update, Missing emigrants projects*. 27 november 2015

Iyengar, Shanto. *Is Anyone Responsible? How Television Frames Political Issues*. Chicago: University of Chicago Press. 1991

Syrian refugees drowning, [https://www.google.al/search?q=refugjatet+ siriane+ne+mediat+ shqiptare&biw=1360&bih=662&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjSg8DE_t_RAhWCJZoKHxOBDA44FBD8BQgGKA#tbm=isch&q=syrian+refugees+drowning](https://www.google.al/search?q=refugjatet+siriane+ne+mediat+shqiptare&biw=1360&bih=662&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjSg8DE_t_RAhWCJZoKHxOBDA44FBD8BQgGKA#tbm=isch&q=syrian+refugees+drowning) accessed on January, 2016

Eksodi shqiptar,
[https://www.google.al/search?q=refugjatet+siriane+ne+ mediat+ shqiptare &biw=1360&bih=662&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0 ahUKEwjSg8DE_t_RAhWCJZoKHxOBDA44FBD8BQgGKA E#imgsrc=ART_oowIHatuFM%3A](https://www.google.al/search?q=refugjatet+siriane+ne+mediat+shqiptare&biw=1360&bih=662&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjSg8DE_t_RAhWCJZoKHxOBDA44FBD8BQgGKA#imgsrc=ART_oowIHatuFM%3A) accessed on January, 2016